

Sekretari i Kompanisë

Sekretari i Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS bënë pjesë në zyrtarët e lartë të kompanisë i cili emërohet nga bordi i drejtorëve.



Z. Arsim Deliu
Sekretar i kompanisë

Sekretari i kompanisë (Sekretari) është agjent i autorizuar i ndërmarrjes dhe kryen detyrat si në vijim:

- a) Mirëmban regjistrin e aksionarëve;
- b) Vepron si agjent i kompanisë për pranimin e njoftimeve;
- c) Mban shënime, arkiva, publikime dhe çështje tjera të nevojshme për autoritetin përkatës siç kërkohet nga Ligji ose ky Statut;
- d) Bën koordinimin e përgatitjes së dokumenteve me KE-në për takimin e Bordit.

Sekretari mban procesverbalin e çdo mbledhjeje të përgjithshme të Bordit të drejtorëve, komiteteve të themeluara nga Bordi dhe komisioni i auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre) dhe do t'i regjistrojë ato në librin e protokollit. Procesverbali do të përmbajë informatat si në vijim: emrat e pjesëmarrësve, vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, çështjet kryesore të ngritura gjatë mbledhjes, tekstin e vendimeve të propozuara dhe rezultatin e secilit votim dhe votat e secilit pjesëmarrës), tekstin e saktë të vendimeve të nxjerra si dhe çfarëdo kundërshtimi të ngritur në lidhje me vendimet e sjella.

Procesverbali i Mbledhjes së përgjithshme do të nënshkruhet nga kryesuesi i Mbledhjes së përgjithshme dhe sekretari dhe do t'i dorëzohet për aprovim në mbledhjen e ardhshme të përgjithshme. Sekretari do të lëshojë një kopje të certifikuar të procesverbalit. Procesverbali i mbledhjes së përgjithshme do të jetë në dispozicion për aksionarët sipas kërkesës me shkrim.

Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të drejtorëve dorëzohet për aprovim në mbledhjen e ardhshme të bordit të drejtorëve. Procesverbali i secilës mbledhje do të nënshkruhet nga sekretari dhe kryesuesi i Bordit të drejtorëve dhe do të shpërndalet tek anëtarët e bordit. Rregullat e njëjta do të aplikohen për procesverbalin e komisionit të auditimit.

Auditori i Brendshëm

Zyrtari i auditimit të brendshëm emërohet nga Komisioni i Auditimit të Bordit të Drejtorëve të Kompanisë.

Zyrtari i auditimit të brendshëm punon nën mbikëqyrjen e komisionit të auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht këtij komisioni. Zyrtari i auditimit të brendshëm i kompanisë është përgjegjës për:

- a) Dhënien e udhëzimeve, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit duke përzgjedhur vet personelin e tij;
- b) Udhëzimin dhe menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm; dhe
- c) Kryerjen e çfarëdo pune tjetër relevante me kërkesë të komisionit të auditimit.